

URDHËR
Nr. 5, datë 11.1.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR NJOHJEN E PERSONELIT TË SHËRBIMIT TË INFORMACIONIT TË FLUTURIMIT TË AERODROMIT

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për njohjen e personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Kjo rregullore është e detyrueshme të aplikohet nga ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror.
3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR NJOHJEN E PERSONELIT TË SHËRBIMIT TË INFORMACIONIT TË FLUTURIMIT TË AERODROMIT

Neni 1

Objekti i rregullore

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për lëshimin, rivalidimin, rinovimin dhe pezullimin e një dëshmie të personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit.
2. Një shërbim i informacionit të fluturimit të aerodromit sigurohet vetëm nga mbajtësi i dëshmisë së personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, që përfshin një vlefshmëri aktuale për vendin në të cilin ofrohet shërbimi.
3. Aplikanti, përpara lëshimit të një dëshmie të personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, duhet të përmbushë disa kërkesa në lidhje me moshën, njohuritë, përvojën, aftësitë, gjendjen mjekësore, si dhe aftësisë gjuhësore.
4. Dëshmia e personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit do të jetë e vlefshme jo më shumë se 3 vjet nga data e lëshimit.
5. Dëshmia e personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit do të ketë formatin e përshkruar në aneksin bashkëlidhur këtij urdhri.

Neni 2

Kushtet për dëshminë

Që të pajiset me dëshmi personeli të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, aplikanti duhet të përmbushi të gjitha kriteret në vijim:

1. Të jetë të paktën mbi 18 vjeç;
2. Të ketë certifikatë mjekësorë të klasit 3;

3. Të ketë vlefshmëri të miratimit të aftësisë gjuhësore, në varësi të nivelit të përcaktuar në përputhje me nenin 4;

4. Të ketë vërtetim të përfundimit me sukses të një kursi fillestar trajnimi (bazik dhe *rating*) dhe trajnimin e njësisë (teori dhe OJT (*on-the-job training*)).

5. Të kryejë praktikë nën mbikëqyrjen/kujdesin e një personeli të informacionit të Shërbimit të Fluturimit të Aerodromit të kualifikuar për jo më pak se një periudhë të caktuar kohe.

Neni 3

Aftësia mjekësore

1. Personeli i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit duhet të plotësojë kërkesat e zbatueshme të përshtatshmërisë mjekësore për detyrat që ata ndërmarrin, sipas aneksit IV të urdhrit të ministrit përgjegjës për transportin ajror nr. 91, datë 21.2.2019, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative, në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror”.

Një certifikatë mjekësore lëshohet nga një ekzaminues mjekësor i autorizuar për të vërtetuar që personeli i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit është i aftë nga ana mjekësore.

2. Për të siguruar një shërbim të trafikut ajror, personeli i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit duhet të mbajë një certifikatë mjekësore të vlefshme.

3. Periudha maksimale e vlefshmërisë së një certifikate mjekësore, të lidhur me një dëshmi personeli të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, nuk do të kalojë periudhat e mëposhtme:

- për personelin e Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit nën moshën 40 vjeç do të ketë vlefshmërinë 24 muaj;

- për personelin e Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit mbi moshën 40 vjeç do të ketë vlefshmërinë 12 muaj.

4. Dëshmia e personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit nuk është e vlefshme, kur mbajtësi vlerësohet si i papërshtatshëm. Në rrethana të tilla, mbajtësi i dëshmisë së personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit nuk duhet të ofrojë shërbime të trafikut ajror, edhe pse deklarata mjekësore e mbajtur mund të mos ketë skaduar.

Neni 4

Vlefshmëria e miratimit të aftësisë gjuhësore

1. Personeli i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit nuk do të ushtrojë privilegjet e dëshmive të tyre, pa pasur një miratim të aftësisë gjuhësore në gjuhën angleze.

Miratimi i aftësisë gjuhësore do të tregojë gjuhën, nivelin e aftësisë dhe datën e skadencës.

Niveli i aftësisë gjuhësore do të përcaktohet në përputhje me shkallën e vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të aneksit I të ICAO-së dhe aplikanti duhet të tregojë së paku në një nivel operacional (niveli katër).

2. Vlefshmëria e miratimit të aftësisë gjuhësore është si më poshtë:

a) për nivelin operacional (niveli katër): tre vjet nga data e vlerësimit;

b) për nivelin e zgjeruar (niveli pesë): gjashtë vjet nga data e vlerësimit;

c) për nivelin ekspert (niveli gjashtë): nëntë vjet nga data e vlerësimit, për gjuhën angleze.

Neni 5

Trajnimi i personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit

1. Trajnimi i personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit do të konsistojë në hapat e mëposhtëm:

a) Trajnimi fillestar për personelin e Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, i cili duhet të përmbajë një numër disiplinash (siç parashikohet më poshtë), për të cilat do të krijohet një plan dhe program trajnimi nga ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror. Plani dhe programi i trajnimit duhet të miratohen nga Autoriteti Kompetent (Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar – AAC). Në fund të programit fillestar të trajnimit do të bëhet një provim për të konfirmuar përfundimin me sukses të trajnimit.

b) Pas trajnimit fillestar, personi do të vazhdojë me trajnimin në njësinë e Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit. Trajnimi në njësi miratohet nga autoriteti kompetent.

2. Pas përfundimit të trajnimit të njësisë, do të bëhet një provim/vlerësim për të konfirmuar përfundimin me sukses të trajnimit. Në momentin që personeli i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit plotëson të gjitha kushtet, ai/ajo do të autorizohet të ndërmarrë detyrat e një personeli të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit.

3. Rivalidimi i dëshmisë do të kryhet pas vlerësimit të kompetencës, e cila duhet të duhet të kryhet një muaj përpara skadimit të vlefshmërisë së dëshmisë së personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit. Për procesin e rivalidimit personeli duhet të ketë përfunduar trajnimin rifreskues dhe të emergjencave.

Neni 6

Trajnimi teorik bazik

1. Trajnimi teorik bazik do të përfshijë lëndët e mëposhtme:

a) hyrje (arsyeja e trajnimit, orari, dokumentet);

b) legjislacionin e aviacionit, shërbimet e trafikut ajror (ATS), Shërbimin e Informacionit të Fluturimit (FIS), shërbimet e përgjithshme të trafikut ajror dhe hapësira ajrore, organizimi brenda shtetit;

c) menaxhimi i trafikut ajror (procedurat e koordinimit, rregullat e ajrit, procedurat e trafikut ajror dhe që kanë të bëjnë me operacionet e aerodromit) (sipas SERA, dok. 4444 dhe materialit udhëzues të EUROCONTROL-it për Shërbimin e Informacionit të Fluturimit të Aerodromit – AFIS);

d) Procedurat dhe praktikat që kanë të bëjnë me shërbimin e informacionit të fluturimit dhe shërbimin e paralajmërimit;

e) termat e përdorur në shërbimin aeronautik mobile, fjalët dhe frazat e procedurës, alfabetin drejtshkrimor; frazeologjitë e radiotelefonisë dhe procedurat e funksionimit;

f) kodet e komunikimit dhe shkurtesat e përdorura (AIC RTF, AFIS DOC, treguesit e vendndodhjes);

g) meteorologjia (FIS; SIGMET);

h) lundrimi (hyrje në GNSS; EGNOS; IAP; SIDs);

i) avionët (performanca);

j) faktorët njerëzorë (me bazë tokësore; ajrore; IFR; VFR);

k) pajisjet dhe sistemet (RT, sistemi i ndriçimit, PAPI);

l) mjedisi profesional (pajisje zjarrfikëse/shpëtimi);

m) situata të pazakonta/të degraduara/emergjente (me bazë tokësore, ajrore);

n) aerodromi (paraqitja, specialet, rregullat e aerodromit lokal; karakteristikat e trafikut lokal; terreni lokal dhe pikat kryesore të dukshme).

2. Trajnim bazik në simulator.

Neni 7 **Trajnimi i njësisë**

Trajnimi i njësisë do të përfshijë temat e mëposhtëm:

a) trajnimi teorik mbi hapësirën ajrore, si dhe standardet dhe procedurat lokale;
b) trajnim në vendin e punës në një minimum orësh, të cilat do të përcaktohen në skemën e kompetencës së personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit.

Aftësi-kompetencë e demonstruar, në:

i. manipulimi dhe funksionimi i pajisjeve dhe i kontrolleve tipike të transmetimit/marrësit, duke përfshirë objektet ndihmëse dhe aparatet e gjetjes së drejtimit të radios, nëse përdoren në aerodromin AFIS;

ii. inspektimi vizual dhe kontrolli ditor operacional i pajisjeve të radios në përdorim;

iii. transmetimi i mesazheve të telefonisë, përfshirë teknikën e saktë të mikrofonit, shqiptimin dhe cilësinë e të folurit, dhe marrja e mesazheve të telefonisë dhe aftësia për të transmetuar mesazhe – veçanërisht pastrimet e ATC – në mënyrë korrekte.

Neni 8 **Trajnimi rifreskues**

Kursi i trajnimit rifreskues do të miratohet nga Autoriteti Kompetent (Autoriteti i Aviacionit Civil). Trajnimi rifreskues do të hartohet për të rishikuar, forcuar ose përmirësuar njohuritë dhe aftësitë ekzistuese të personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, për të ofruar një rrjedhje të sigurt, të rregullt dhe të shpejtë të trafikut ajror.

Neni 9 **Mbajtja e kompetencës së personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit**

Në mënyrë që një personel i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit të mbajë vlefshmërinë e dëshmisë së lëshuar nga AAC-ja, ata duhet të përmbushin kërkesat e skemës së kompetencës, e cila do të hartohet nga ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe do të miratohet nga AAC-ja.

Neni 10 **Skema e kompetencës së njësisë**

1. Skemat e kompetencës së njësisë do të krijohen nga ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe aprovohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar. Ajo do të përfshijë së paku elementet e mëposhtme:

a) vlefshmërinë e miratimit të njësisë;

b) periudhën maksimale të vazhdueshme, kur privilegjet e një miratimi të njësisë nuk ushtrohen gjatë vlefshmërisë së tij;

c) numrin minimal të orëve për ushtrimin e privilegjeve të miratimit të njësisë brenda një periudhe të përcaktuar kohe;

d) procedurat për rastet kur mbajtësi i dëshmisë nuk përmbush kërkesat rregullative;

e) proceset për vlerësimin e kompetencës, duke përfshirë vlerësimin e subjekteve trajnuese të përditësuara;

f) dispozitat për të rimarrë kompetencën për të punuar si personel i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, pas periudhave të gjata të mungesës;

g) procesi dhe arsyet për rishikimin dhe ndryshimin e skemës së kompetencës së njësisë dhe dorëzimit të saj tek Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar;

h) kohëzgjatja minimale dhe frekuenca e trajnimit rifreskues.

2. Me marrjen e plotë të dokumenteve, AAC-ja do të verifikojë nëse plotësohen të gjitha kërkesat e përshkruara.

3. Nëse dokumentet e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC-ja do t'i dërgoj një njoftim aplikantit dhe ofruesit të Shërbimit të Lundrimit Ajror, duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

Neni 11

Pezullimi dhe revokimi i dëshmisë të personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit

1. Dëshmia për personelin e Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit mund të pezullohen ose revokohet nga AAC-ja, kur zotëruesi nuk përputhet me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. AAC-ja do të analizojë me kujdesin e duhur çdo situatë të prezantuar apo të zbuluar gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse, për të përcaktuar anulimin apo revokimin e kësaj dëshmie, kategorive dhe miratimeve. AAC-ja mund t'i kërkojë ofruesit të Shërbimit të Lundrimit Ajror të prezantojë prova shtesë për një qartësim më të mirë të situatës të zbuluar gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes.

Neni 12

Procesi i anulimit

1. AAC-ja do të pezullojë apo anulojë një dëshmi të personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, në rrethanat e mëposhtme:

a) ushtrimi i privilegjeve të dëshmisë të personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, kur zotëruesi nuk përputhet më me kërkesat e aplikueshme.

b) falsifikimi i dëshmisë së personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit ose dokumenteve përkatëse;

c) ushtrimi i privilegjeve të dëshmisë së personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit nën ndikimin e substancave psikoaktive;

d) me kërkesë të zotëruesit.

2. AAC-ja mund të pezullojë apo anulojë dëshminë e personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit, kur identifikohet një çështje parrezikshmërie gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse ose nga mënyra të tjera ku janë gjetur prova për mospërputhje në këtë procedurë.

Neni 13

Procesi për pezullim ose anulim, si dhe e drejta për apelim

1. Në rastet e anulimit ose të pezullimit, AAC-ja do të informojë personelin e Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit dhe ofruesin e Shërbimit të Lundrimit Ajror me shkrim mbi vendimin dhe të drejtën e tyre për të apeluar. Kjo do të mbartet në një dokument të firmosur nga titullari i AAC-së, brenda 48 orëve nga vendimi për të pezulluar apo për të anuluar dëshminë e personelit të Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit. Anulimi do të nisë 24 orë pas lëshimit të dokumentit nga AAC-ja.

2. Brenda 5 ditëve nga marrja e dokumentit të anulimit/pezullimit nga AAC-ja, personeli i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit mund të apelojë vendimin e AAC-së. Kjo do të bëhet me shkrim dhe do të përfshijë, si minimum, dokumentet e mëposhtme:

- a) referencë për dokumentin e AAC-së;
- b) arsyeja për apelim; dhe
- c) adresë për komunikim të mëtejshëm.

3. Brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së apelimit, AAC-ja do të mundësojë një përgjigje të shkruar për zotëruesin e privilegjit.

Neni 14

Instruktorët/vlerësuesit

Instruktorët për personelin e Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit do të emërohen në përmbushje të kushteve të mëposhtme:

- a) ka kryer me sukses një kurs për teknikat mësimore;
- b) ai ka të paktën dy vjet përvojë operative me kohë të plotë si personel i Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit;
- c) mban dhe ka mbajtur për një periudhë minimale prej një viti, certifikatat e kompetencës për pozicionin për të cilin do të zhvillohet mësimi;
- d) ka kryer një kurs të miratuar OJTI (instruktorit të trajnimit në vendin e punës) ose VLE (vlerësues).

Neni 15

Autorizimi i përkohshëm i OJTI dhe/ose VLE

a) Kur përputhshmëria me kërkesat e parashikuara në nenin 14 nuk është e mundur, Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar mund të japë autorizim të përkohshëm të OJTI-së, bazuar në një analizë parrezikshmërie (*safety*) të paraqitur nga ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror.

b) Autorizimi i përkohshëm i OJTI-së dhe/ose VLE-së i referuar në shkronjën “a” mund të lëshohet për mbajtësit e një miratimi të vlefshëm OJTI dhe/ose VLE të lëshuar në përputhje me nenin 14.

c) Autorizimi i përkohshëm i OJTI-së dhe/ose vlerësues i referuar në shkronjën “a” do të kufizohet në instruksionin e nevojshëm për të mbuluar situata të veçanta dhe vlefshmëria e tij nuk do të tejkalojë një vit, por nuk duhet të tejkalojë vlefshmërinë e miratimit të OJTI/VLE të lëshuar në përputhje me nenin 14.

d) Për lëshimin e një autorizimi të përkohshëm, për arsyet e referuara në shkronjat “b” dhe “c” Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar mund të kërkojë një analizë sigurie për t’u paraqitur nga ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror.

ANEKS
DËSHMI E PERSONELIT TË SHËRBIMIT TË INFORMACIONIT TË FLUTURIMIT TË
AERODROMIT

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar

DËSHMI [NUMËR/REFERENCË]

Sipas kësaj rregulloreje dhe sipas kushteve të specifikuara më poshtë [Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar] vërteton që:

[EMRI I APLIKANTIT]
[ADRESA E APLIKANTIT]

Do të operojë si personeli Shërbimit të Informacionit të Fluturimit të Aerodromit.

KUSHTET:

1. Kjo dëshmi kërkon përputhje me rregullat dhe procedurat zbatuese të specifikuara në këtë rregullore.
2. Kjo dëshmi do të jetë e vlefshme për një periudhë trevjeçare deri më [xx.yy.zzzz]¹, sipas përputhshmërisë me kërkesat rregullative, përveç nëse ajo dorëzohet, zëvendësohet, kufizohet, pezullohet ose revokohet.

Data e lëshimit

Nënshkrimi: [Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar]

¹ Data e skadencës: dita.muaji.viti.